

Etika për fëmijë

Dhurata e përmuajtshme, nga revista "Etika"

Viti 2 - Numri 22 - Tetor 2012

*Një buzëqeshje
e ëmbël...*

Ç'DUHET TË BËJMË PËR TË PASUR SUKSESE NË MËSIMET?

Çarë Tashgetiren

Suksesi në shkollë, përveç punës së madhe mësimore, arrihet duke njohur mirë edhe mënyrat efikase, frytdhënëse, të programuara dhe sistematike të punës. Ejani të ndjekim hap pas hapi mënyrat e duhura për të arritur suksesin në mësimet:

1- Pikësëpari, duhet të keni një qëllim. Ta zëmë se qëllimi juaj, është që në fund të shkollës, të merrni një dëftesë me të gjitha notat 10-ta! Këtë dëshirë, duhet ta mbani gjithmonë të gjallë në mendjen tuaj dhe për ta realizuar atë bëni përpjekje të mëdha. Nëse doni, këtë dëshirë mund ta shkruani në një letër, si: "Në fund të shkollës, dëftesa ime do të jetë vetëm me 10-ta!", ose mund të vizatoni një dëftesë të mbushur me 10-ta dhe ta varni atë në murin e dhomës suaj.

2- Filloni me bismilah, pastaj bëni dua (lutje). P.sh., mund të thoni: "O Allah! Ma lehtëso punën dhe mos ma vështirëso!

O Allah më jep mirësi dhe sukses në çdo punë."

3- Gjatë orës së mësimet, dëgjoni mësuuesin me shumë vëmendje. Nëse njeriu nuk e mban mendjen në mësim, mund të shpërqendrohet shumë lehtë. Një temë, e cila shpjegohet në 40 minuta mësimi, nuk mund të mësohet edhe sikur të lexoni vetë për 2-3 orë. Shkolla dhe mësuuesi janë lehtësues në të kuptuarit e mësimet. Nëse nuk e dëgjoni mësimin, do të jeni të detyruar që të punoni më shumë për ta kompensuar vetë atë që keni humbur në mësim. Megjithatë, asnjë punë tjetër nuk mund t'i zëvendësojë ato që mësoni gjatë orës së mësimet. Pra, edhe nëse mësoni vetë, nuk do të arrihi ta kuptoni ashtu siç duhet mësimin.

4- Uluni drejt në bankë dhe shikojeni mësuuesin në sy. Mos luani me mjetet mësimore, si: lapsi, goma etj. Nëse shoku që keni pranë mundohet të flasë me ju apo të bëjë shaka dhe lojëra të ndryshme, i thoni se do të flasin në pushim.

5- Programoni kohën tuaj! Bëni një program të mirë me qëllim që ta shfrytëzoni sa më mirë kohën kur ndodheni në shtëpi. Caktojini mirë orët e pushimit dhe të mësimet. Gjatë kohës së mësimetve mos mendoni për lojë dhe gjatë kohës së pushimit mos mendoni për mësimet.

6- Mësimin që keni mësuar në shkollë, përsëriteni patjetër në shtëpi po atë ditë. Disa studime shkencore kanë dalë në përfundim se 50% të mësimetve të cilat nuk përsëriten në të njëjtën ditë që merren në shkollë, harrohen shumë shpejt. 10 minuta përsëritje që do të bëni në shtëpi, do t'ju ndihmojë që mësimet t'ju fiksohen më mirë në mendje. Në të njëjtën mënyrë, edhe përsëritja që do të bëni në fund të javës, do t'ju ndihmojë që mësimet të mos fshihen lehtë nga mendja juaj.

7- Pasi të keni mbaruar detyrat dhe të keni përsëritur mësimin e asaj dite, hidhni një sy temave dhe mësimetve që do të merrni të nesërmen. Kjo parapërgatitje do t'ju ndihmojë



që ta dëgjoni më me vëmendje mësuesin dhe t'i kuptoni më mirë temat. Nëse nuk veproni kështu, do ta keni më të vështirë t'i kuptoni mirë temat të cilat i hasni për herë të parë.

8- Duhet të pushoni patjetër midis orëve të mësimit. Puna pa pushim, e lodh trurin. P.sh, nëse keni punuar 40 minuta, atëherë duhet të pushoni 20 minuta. Pasi të keni mbaruar një detyrë apo një mësim, shpërblejeni veten tuaj. Pra, mund të shihni një program televiziv të cilin e pëlqeni, mund të bisedoni me vëllezërit apo motrat ose edhe mund të luani.

9- Mos mësoni shtrirë ose duke qenë para televizorit. Një mësim të cilin mund ta kuptoni për gjysmë ore, para televizorit nuk do ta kuptoni mbase as për dy orë. Mbaroni detyrat dhe mësimet, pastaj shikoni televizor. Ndërkohë që pushoni, mendja juaj duhet të jetë e qetë. Dhe këtë qetësi mund t'ju japë vetëm gëzimi i mbarimit të mësimëve.

10- Mësoni t'i thoni "jo" shokëve. Kur ktheheni nga shkolla në shtëpi, shokët e lagjes mund t'ju thërrasin për të luajtur jashtë. Mos kini turp që t'u thoni "jo" në mënyrë të sjellshme.



Në radhë të parë vjen programi që keni bërë. Pastaj programi edhe një kohë për të luajtur së bashku me ta.

11- Përpikuni që në shkollë të jeni aktiv. Pyeteni mësuesin tuaj për çdo gjë që nuk e keni kuptuar në lidhje me mësimin. Mësuesit i duan shumë nxënësit që janë kureshtarë dhe pyesin.

12- Nëse punoni me plan, detyrat nuk ju mbliidhen kapicë dhe kur të vijnë provimet, nuk do të ngeleni nën peshën e mësimëve që nuk i keni ditur më parë. Prandaj dhe gjatë provimit nuk do të shqetësoheni dhe nuk do të bëni panik.

13- Merrni shënime! Merrni shënime të shkurtra prej atyre që lexoni, sepse ato që mësoni do të fiksohen më mirë në mendjen tuaj dhe nuk do t'i harroni lehtë.


14- Ndonjëherë, provoni të mësoni dhe të lexoni me zë.

15- Vini trurin në punë në lidhje me temën që po mësoni! Bëni pyetje! Provoni të mësoni duke nxjerrë pyetje prej mësimëve.

16- Bëni lidhjen e atyre që mësoni me jetën e përditshme. Pra, lidhni gjërat që mësoni me ato që jetoni. Ku dhe si mund t'i përdorni në jetën tuaj?

17- Jini entuziastë! Filloni mësimet me entuziazëm dhe me shpresë.

18- Gjërat interesante që keni mësuar, ndajini edhe me prindërit tuaj.



**Etika
për fëmijë**

Drejtor
& Kryeredaktor:
Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23 989

Redaktor:
Xhahid Bushati
xhahidbushati@yahoo.com
+355 69 28 20 975

Redaktore gjuhësore:
Dr. Irida Hoti
Përkthyes:
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

Dizajn - Grafik:
Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com

Adresa: L: Vasil Shanto - Rr: Çajupi - Shkodër - Albania / Tel: +355 22 254 634 / Fax: +355 22 254 633
Zyra e përfaqësimit Maqedoni: Rr: Stiv Naumov - Nr. 9 - lokal 25 - Shkup - Maqedoni / Tel: +389 71 956 271
Zyra e përfaqësimit Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu - pn. Ralin - Prizren - Kosovë / Tel: +381 29 222 795

VJESHTA PIKTORE

-kolazh poetik- -pjesa e dytë-

1.

**Një kaçubë-shtëpi
më tej vizatoi.
(Për ty, o iriq
Vjeshtëza mendoj.)**

**-Vjeshtë, mos harro,-
dimrit më zë kolla.
(ajo i dhuroi
një shportëz me molla).**

**Dhe... iriq mos dil
në ditët me erë,
sepse do të ftohesh
e do bësh gjilpërë.**

**Por iriq gjembaçi
foli shend e verë:
-Më mirë shurup molle
se sa një gjilpërë.**

2.

**Vjeshta zgjat penelin
dhe ca ngjyra hedh...
(me një ngjyrë kafe,
bën zgavër të thellë,**

**Se aty bën gjumë
ariu babaxhan.
Kujdes, mos e zgjoni,
nis e hungëron...)**



**Vjeshta bën ca dardhë,
dhe një qyp me mjaltë...
(Bletët xha ariut
ia sollën dhuratë).**

**Xha ariut s'i pritet,
si gjysh nis e flet:
-Vjeshtë, po hyj në zgavër...,
se bëj gjumë të qetë.**

**3.
Bëri një vogëlush
(po shkante në shkollë),
Vjeshta e gostiti
me rrush e me mollë.**

**I bëri një zile
(e fton për mësim),
dhe një çantë të bukur
i dha si kujtim...**

**I fali ca lule
të verdha si hëna,
i fali dhe këngë,
dhe një tufëz ëndrra!**

**4.
Vjeshta si piktoe
erdhi sot në pyll
bëri këtë tablo
me laps e me ngjyrë.**



NJË BUZËQESHJE -prozë poetike- E ËMBËL...

Hymejra Karagëz

Një buzëqeshje e ëmbël... Ja pra, kaq e thjeshtë është çdo gjë! Mbase mirësia më e lehtë dhe më pa mundime e botës... Sevapi që i jep shpirtit tonë qetësinë e një mirësie...

Mendoni pak atë buzëqeshje me bukuri të pashoqe të Profetit tonë të dashur (a.s.), kur ka thënë: “Buzëqeshja ndaj vëllait tënd besimtar, është sadaka...” . Sa shembull i bukur është ai!

Nëse edhe një buzëqeshje e vogël qenka sadaka dhe ne e kemi në dorë që të japim sadaka çdo ditë dhe çdo çast, përse të mos e përdorim? Edhe vetë do të lumturoheni, edhe atë që keni përballë do ta lumturon, edhe sevape do të fitoni. A ka sjellje më të ëmbël se kjo?!

T’i buzëqeshësh një shoku që po nxiton t’ju arrijë nga mbropa kur jeni duke shkuar në shkollë... T’i buzëqeshësh duke e parë në sy një të moshuar që ka dalë për të shëtitur kur ju jeni duke luajtur në oborr... Ta bësh nënën tënde për një çast nënën më të lumtur të botës, duke i dhuruar asaj një buqetë buzëqeshjesh pa pasur asnjë arsye dhe duke e ndjerë thellë në shpirt dashurinë e saj...

T’i jepni selam një të panjohuri duke buzëqeshur kur jeni duke kaluar në rrugë... Mbase edhe kur të jeni në lagje, të jepni selam vazhdimisht të qeshur... Të buzëqeshësh... Një dhuratë e bukur që mund t’ia dhuroni vëllezërve tanë besimtarë edhe sikur të mos keni asgjë tjetër për të dhënë...

“Një buzëqeshje e ëmbël”, edhe sikur të jetë pasuria jonë e vetme... “Një pasuri” e cila shtohet sa më shumë të shpenzohet, që na dhuron qetësi sa më shumë të shpenzohet, që na gëzon edhe me gjëra të vogla sa më shumë të shpenzohet dhe që e bën njeriun të dëshirojë të shpenzojë sa më shumë që e shpenzon... Një buzëqeshje e ëmbël... Qetësia e pashoqe e së cilës na bën ta ndjejmë thellë në

shpirt buzëqeshjen e të Dashurit tonë (a.s.)...

Tani!

Buzëqesh... Për hir të vëllait tënd besimtar që ke përballë...

Buzëqesh... Për hir të Allahut, buzëqesh...

Do të shohësh se; kur të buzëqeshësh, edhe “Bota” do të buzëqeshë nën udhëheqjen e të Dashurit tonë (a.s.)!






Behlul
Bera

Një mësim nga mësimet e Hadithit

- pjesa e tetë -



SHKOLLAT ISHIN HAPUR. KISHTE FILLUAR
VITI I RI SHKOLLOR. NGA SHKOLLA DËGJOHESHIN
ZËRAT E FËMIJËVE TË GËZUAR.



TË GJITHË I KISHTE MARRË MALLI PËR NJËRI-TJETRIN.
FËMIJËT PO BISEDONIN ME SHOKËT E TYRE SIKUR PO
NXIRRNIN DHIMBJEN E KOHËS QË NUK ISHIN TAKUAR.

BEFAS U HAP DERA. MËSUESI ERDHI.
ZHURMA IA LA VENDIN HESHTJES DHE
SHIKIMEVE KURESHTARE.



ZEHRRA U UL PRANË FATBARDHËS. FATBARDHA ISHTE NJË VAJZË E MIRË, POR KISHTE NJË MANGËSI TË VOGËL. AJO ISHTE PAK MENDJEMADHE.




ZEHRRA NUK ARRITI TË BËHEJ SHOQE ME FATBARDHËN. PËR KËTË ARSYE, GJATË PUSHIMEVE TË SHKURTRA QËNDRONTE E VETME NË KLASË.



SAMIU I VOGËL MËRZITEJ NGAQË ZEHRRA KISHTE NGELUR VETËM. NJË DITË, GJYSHI I KISHTË THËNË: “KUR TË SHIKOSH DIKË NË VËSHTIRËSI, DIJE SE TASHMË, AJO VËSHTIRËSI ËSHTË EDHE E JOTJA, SEPSE ALLAHU TA KA TREGUAR ATË VËSHTIRËSI QË TË FITOSH KËNAQËSINË E TIJ DUKE SHFAQUR NJË SJELLJE TË BUKUR.”



SAMIU I VOGËL, SË PARI U TAKUA ME FATBARDHËN. PASI MORI APROVIMIN E SAJ, FOLI ME MËSUESIN DHE I THA SE DËSHIRONTE TË ULEJ PRANË ZEHRËS.



Sami, unë po shkoj
në kantinë. Eja edhe
ti po deshe.

Rrofsh,
unë dua të lexoj.



Edhe unë të
vizatoj të
paktën.



Sa bukur që vizaton! A
mund t'i shikoj vizatimet që
ke në dosje?



Ti do të bëhesh një piktores
e madhe! Edhe unë do
dëshiroja të vizatoja si ti.



Edhe ti mund të vizatosh.
Unë mund të të mësoj ty.
Nëse dëshiron, mund të
fillojmë menjëherë.

Eel Kur mësuesi është i mirë, edhe nxënësi bëhet i mirë.

Samir! Paske vizatuar shumë bukur.

PAS PAK, TË GJITHË KLASËN E ZURI MERA-KU PËR TË VIZATUAR. NË PUSHIM ISHTE SHTUAR NUMRI I ATYRE QË DËSHIRONIN TË VIZATONIN DHE TË GJITHË KISHIN FILLUAR TË BËNIN NJË GJË TË TILLË.

Shiko, unë bëra këtë.

Paska dalë shumë bukur.

A mund të vizatoj edhe unë vallë?

RA ZILJA E MËSIMIT DHE NXËNËSIT KISHIN FILLUAR TË VININ NË KLASË NJË NGA NJË.

Zehra, macen e kam vizatuar siç më mësove ti. A ka dalë bukur?

EDHE FATBARDHA I ISHTE BASHKUAR KLASËS DHE KISHTE FILLUAR TË VIZATONTE.

Samir, nëse më lejon, unë dua të qëndroj më Zehrën.

FATBARDHA E KISHTE KËPUTUAR SE NUK ISHTE SJELLË MË ZEHREN ASHTU SIÇ DUHEJ. TASHMË DËSHIRONTE TA RREGULLONTE GABIMIN QË KISHTE BËRË.

“MË I MIRI PREJ JUSH, ËSHTË MË I DOBISHMI PËR NJERËZIT.”

(HADITH FISNIK)



TASHMË ZEHRA ISHTE BËRË SHOQJA MË E NGUSHTË E FATBARDHËS. NË TË NJËJTËN KOHË, EDHE MËSUESJA E SAJ E VIZATIMIT...

Qerpiçi

Kohë më parë ishte një burrë që quhej Enes, i cili tregonte kujdes të veçantë ndaj namazit dhe ndaj fesë. Një ditë, teksa po rregullonte murin e shtëpisë, gjeti një grumbull florinjsh të shtruar në formë qerpiçi. U gëzua pa masë dhe mendoi me vete: "Tashmë shpëtova nga varfëria. Do të bëj një saraj të bukur. Dyshtemenë do ta shtroj me mermer të bardhë dhe dhomat do t'i mbush me mobiljet më të mira. Në bahçe do të ketë lule ngjyra-ngjyra dhe pemë frutore të ndryshme. Në këto pemë do të cicërojnë zogjtë më të bukur të botës."

Atë natë e zuri gjumi me këto imagjinata.

Kaq shumë e kishte rrëmbyer vala e gëzimit

sa filloi të imagjinonte edhe për shërbëtorët, edhe kuzhinierët që do të merrte në shtëpinë e re...

Duke humbur nëpër të tilla fantazi, nuk i dilte kohë më për të ngrënë, për të pirë, për të falur namaz, madje as për të falënderuar Allahun që ia dha këtë mirësi.

Një ditë, ndërsa Enesi po shëtiste jashtë qytetit i humbur në mendime, pa një burrë që po priste qerpiçe pranë varrezave. Burri gërmonte tokën me kazëm e lopatë, ndërsa dheun që nxirrte e përzinte me kashtë dhe e hidhte në kallëpin e qerpiçeve.


Ai i tha Enesit se qerpiçet e bëra me dhé varrezash ishin më të forta. Enesi u trondit nga këto fjalë, e kritikoi burrin dhe vazhdoi rrugën i menduar...

Burri i foli që larg: "Ah, bre, burrë i çmendur! Një ditë do të presin qerpiç edhe me dheun e varrit tënd. Pasi gjete një grumbull florinjsh, je hutuar fare. E ke lënë namazin dhe fenë. Jeta, çdo ditë po merr diçka nga ti. Vdekjes po i afrosh hap pas hapi. Lëri imagjinatat! Vlerësoje mirë këtë shans që ta ka dhënë Allahu dhe harxhoje paranë me vend! Mos i harxho dhe mos i shpenzo pa kujdes!"

Në ato momente filloi të thirrej ezani i namazit të drekës.

Enesi shkoi drejt xhamisë me qetësinë shpirtërore të atyre që vendosin për të bërë gjëra të mira. Sikur ta dinte më parë këtë hadith të Pejgamberit tonë (a.s.) nuk do të hutohej aq shumë nga pasuria e gjërat materiale:

"Sikur të kisha florinj sa mali i Uhudit, pas tre ditëve nuk do të kisha më shumë se paratë që u kam borxh të tjerëve." (Muslim, Zekat, 4)





Milingona dhe karkaleci

-fabul-

1.

Në një ditë të nxehtë vere, në fushën e gjelbër plot lule që kundërmonte aromë gjithandej, karkaleci po pushonte nën hijen e gjetheve dhe këndonte me gjithë fuqinë e zemrës së tij.

Një milingonë kaloi aty pranë. Ajo ishte lodhur nga rruga e gjatë. Por nuk ndiente lodhje, kur mendonte se drejt folesë së saj, po çonte një kokërr gruri.

- Pse nuk vjen të flasim e të bisedojmë, të kalojmë kohën..., - i tha karkaleci milingonës. Qenke lodhur, pusho!..

- Nuk mundem! Më duhet të mbledh ushqim për dimër, - u përgjigj milingona.

- Dimri është larg... Kohë ke... Të mjaftojnë ditët për të mbledhur ushqim, - i tha karkaleci.

- Nuk mundem!.. Nuk kam kohë të humbas... Mirupafshim, karkalec!

2.

Kur erdhi dimri, karkaleci nuk kishte ushqim në shtëpizën e tij. Ndërsa në shtëpizën e milingonës ushqimi ishte i bollshëm.

Në atë gjendje të vështirë që ishte, karkaleci doli nga shtëpia dhe po ecte rrugës i mërzitur. Rrugës pa milingonën. U çudit dhe e pyeti:

- Për ku kështu, moj milingonë?! - pyeti karkaleci.

- Po nisem për në Qabe, - ia ktheu milingona.

- Je e vockël për në Qabe, moj mikeshë!.. Nuk ke as fuqi!

- Unë po nisem... Dhe për këtë jam e sigurt. Edhe në qoftë se nuk do të mbërrij, do të vdes në rrugën e Qabes dhe sevapi i haxhillëkut do më shkruhet...

Karkaleci nuk foli dhe ishte hera e parë që në heshtje nderonte milingonën punëtore.



PËRRALLËZA E SHKRONJËS P



PORTOKALLI

Thonë se dikur portokalli nuk ka pasur thela.

Një ditë, një vogëlushe me emrin Pranverë mori një kokërr portokalli dhe doli të luante me shoqet. Mirëpo, pa se ato nuk kishin në dorë asgjë për të ngrënë. I erdhi zor ta hante vetëm dhe deshi ta hidhte. Befas dëgjoji një zë të hollë:

- Të lutem, ma zhvoshk lëkurën, pastaj më hidh, po deshe!

Pranvera, e çuditur që portokalli foli me zë njeriu, iu bind dhe... i ndritën sytë nga gëzimi: Ai ishte ndarë në aq thela, sa ishin edhe shoqet e saj. Pranvera i dha nga një thelë secilës dhe një e hëngri për vete.

...Qysh atëherë, frutat e portokallit mbetën të ndara në thela, për të gjithë bujarët e kësaj bote.





Çfarë? Përse? Si?

Zehra Aksoy

HARMONIA MES MUSKUJVE...

Ndoshta nuk e dini, po kur ju qeshni, në fytyrën tuaj kontraktohen në mënyrë të harmonishme 17 muskuj. Nëse ndonjëri nga këto muskuj nuk do të kontraktuhej apo nuk do të funksiononte, ju nuk do të ishit në gjendje të buzëqeshnit. Veç kësaj, ju do të mbeteshit me një shprehje boshe në fytyrën tuaj. Ekzistojnë 28 muskuj që kontrollojnë shprehjen e fytyrës tuaj. Me kontraktimin e përbashkët të këtyre muskujve, ju mund të përfitoni qindra mënyra shprehjeje të ndryshme. Në sajë të këtyre muskujve ju mund të shprehni: zemërim, hutim, gëzim, argëtim dhe shumë emocione të tjera. Përveç muskujve të fytyrës, në trupin tuaj punojnë në harmoni edhe muskuj të tjerë. Për shembull për të hedhur një hap të vetëm, hyjnë njëkohësisht në veprim 54 muskuj.



SI E PASTRON VETEN ZAMBAKU I UJIT?

Disa bimë, vetëpastrohen kur ndoten. Veçoria më e rëndësishme e Zambakut të ujit është se, ndonëse rritet në një ambjent të ndotur, gjethet i mban të pastra. Po mirë, si ndodh ky veprim kaq mrekullor? Sapo bie një grimcë ndotësi mbi gjethë, Zambaku i ujit shkund gjethet dhe ndotësin e shtyn deri në një pikë të caktuar. Sado që nuk vërehet mirë nga jashtë, kjo bimë ka një sipërfaqe të dizajnuar në mënyrë të veçantë në përmasa mikroskopike. Gjethet e Zambakut të ujit janë 5 – 10 mikrometër (1/1000 e milimetrit) të larta dhe 10 – 15 mikrometër me distancë nga njëra – tjetra, ndaj ka një farë dallgëzimi shumë të vogël. Tekfundit, del në pah një sipërfaqe me gjerësi 0.1 mikrometër dhe e përbërë tela në formën e zigzagut. Këto dalje janë të veshura me dyll. Për shkak të kësaj trajte të veçantë të sipërfaqes, bulëzat e ujit nuk krijojnë kontakt me sipërfaqen, dhe për shkak të rëndesës rrjedhin poshtë. Kjo bimë, i përdor pikat e shiut, sikur po bën dush. Pikat e ujit që bien mbi gjethë, drejtohen nga vendet e ndotura dhe pastrojnë pluhurin që ndodhet mbi to.

SI NXJERRIN ZË GJINKALLAT?

Gjinkalla është një insekt i zhurmshëm. Ajo prodhon gumëzhitje me anë të një sistemi në trupin e saj. Poshtë barkut të insektit gjenden një çift organesh membranozë. Gjinkalla prodhon atë tingull shumë të njohur duke dridhur këto membrana si daulle. Kur këto membrana tërhiqen dhe lëshohen nga muskujt me të cilët janë ngjitur, prodhohet një tingull i ngjashëm me atë të një ene të zbrazur metalike. Insekti e përsërit këtë tërheqje-lëshim 500 herë në sekondë. Duke marrë parasysh që ju mund të mbyllni dhe të hapni sytë vetëm një herë në sekondë, shpejt mund të shikoni se sa e vështirë është ta kryesh këtë 500 herë në sekondë. Me hapjen dhe mbylljen e pjesës së jashtme që ndodhet në zonën më të ulët të kafazit të krahavorit të insektit, niveli i tingullit mund të rritet dhe të ulet. Syri i njeriut nuk mund t'i dallojë këto hapje e mbyllje që ndodhin në të dhjetën e sekondës. Ne nuk e vëmë re as faktin se tingulli është i ndërprerë dhe mendojmë se tingulli gumëzhitës i gjinkallës është i vazhdueshëm.



JAHJA BİN FADL

Veziri abasit që ndërtoi fabrikën e parë të letrës në historinë e njerëzimit

Të dashur fëmijë!

Le ta nisim bisedën e sotme duke bërë këto pyetje:

-Ku shkruani, mbi çfarë? Mbi çfarë shtypen revistat, librat dhe gazetatat?

-Mbi letra... Mbi letra shtypen...

-Ju lumtë! Natyrisht që mbi letër. Çdo ditë me qindra herë, me mijëra herë prekim letra. Jetojmë bashkë me letra. S'po ju pyes "ku përdoren letrat?", sepse nuk mbarojnë së numëruari.

Letra është një zbulim shumë i rëndësishëm në historinë e njerëzimit dhe të qytetërimit. Burimet që tregojnë se një lloj letre që quhet papirus, është përdorur në Kinë në vitin 105 të erës sonë, tregon po ashtu se në vitin 707, në Mekë bëheshin shkrime mbi letër. Sërish myslimanët qenë ata që bënë fabrikën e parë të letrës. Jahja bin Fadl është lindur në vitin 739, është nga fisi Bermeki, një prej vezirëve më me famë të shtetit abasit. Ai kishte marrë një edukim të mirë.

U bë vali i Musulit. Kalifi Mehdi, për arsye të suksesit si një funksionar i shtetit, Jahja bin Fadlin e ftoi në Bagdad. I dha detyrë që t'ia edukonte të birin. Kur Haruni u bë kalif, Ibn Fadlin e bëri vezir. Ai i shërbeu me sukses për


17 vite me radhë shtetit abasit.

Shërbimi më i madh i Ibn Fadlit me historinë e shkencave dhe të historisë ishte ndërtimi i fabrikës së parë të letrës në botë. Kjo ngjarje, u bë nisje e një epoke të re.

Të dashur fëmijët e Etikës për fëmijë, le ta vazhdojmë më tej bisedën...

Gutenbergu zbuloi shtypshkronjën në vitin 1436. Kurse Jahja bin Fadl ka krijuar fabrikën e letrës 642 vite para Gutenbergut. Frymëzuesi i Gutenbergut, padyshim që ka qenë Ibn Fadli, i cili kishte ndërtuar fabrikën e parë të letrës. Prof. Risler në veprën "La Civilisation Arabe", në faqen 17, thotë: "Kryqtarët e mësuan kur ishin në Egjipt modelin e shtypjes mbi pëlhura me dizajnim prej dërrase. Ky art, i cili përdorej prej kohësh në Egjipt, u bë shkak që të ndërtoheshin shtypshkronja në Evropë... Në Kordoba, në kohën e Abdurrahmanit III, dihet se letrat zyrtare shtypeshin në një shtypshkronjë që ende sot nuk i dihet mënyra e mekanizmit të saj."

Në lidhje me këtë ngjarje historike të vërtetë, Prof. Dr. Philip Hitti rrëfen kështu: "Franca, fabrikat e para të letrës, i ka marrë drejtpërsëdrejti nga Andaluzia. Ky art, nga aty u përhap gjithandej nëpër Evropë." Ndërsa Dr. Sigrid Hunke ka shkruar se në këto fabrika, nuk janë shtypur vetëm letra zyrtare, por edhe monedha letre dhe letra të tjera. Kurse Gustave Le Bon, i cili ka studiuar burimet islame, shprehet se prodhimi i letrës solli një qytetërim të ri dhe shton: "Myslimanët zbuluan letren e librit, e cila hoqi nga qarkullimi pergamenët." Kurse perëndimori me emrin Libri shprehet në këtë mënyrë: "Nëse do t'i fshinin nga historia mysli-manët, do të mbeste me shekuj mbrapa rilindja jonë shkencore..."





MENDO PAK... E BUZËQESH

Macja gjetí gjëegjzën

A e díní
Ç'bëri Metí,
Kur te vatra
Macen gjetí?

Iu afírua
Dhe e zgjoi
E një gjëzë
I tregoi...



"Nuk ka pushikë
Gjuan mí,
Hë, fol, mace,
E gjen tí?"

Macja qeshí;
Tha: e dí,
Kur përmende
Emrin mí.

- Mamí moí, -
Thirri Metí, -
Gjëegjzën
Macja gjetí.



NJË GAFORRE TOROLLAKE!...

Një gaforre po ecën në bregdet.
Pyet Xhoisi: - Pse ecën me zigzage?
- E di unë! - thotë Eni, me të shpejtë:
Sepse është gaforre torollake!...

LAPSI IM U ÇMENDI!...

Një këndes noton mbi valë,
Mbi çati këndon një ngjalël!...
Peshqit ecin në lëndinë,
Në shkretëtirë - plot pinguinë!...
Breshka fluturon mbi re,
Lepurusha ka bërë ve!...

Nëse lapsi im u çmend,
Ti a di t'i vesh në vend?



KU I KANE SYTË RETË?!

Thotë Eni. Kur unë qaj,
Më rrjedhin lotët vetë.
Fshij syçkat dhe pastaj
Çuditëm shpesh me retë:

Në qiell anembanë,
Dhe ato qajnë me lot.
Po, sytë, ku i kanë,
Përse nuk i shoh dot?!

Nastradin Hoxha





ZBAVITJE



Sudoku!



Plotësoni çdo rresht, kolonë dhe kutizë, në mënyrë që, çdo shifër nga 1 deri te 9, të shfaqet një dhe vetëm një herë.

M U

M Y

Plotësojeni fjalën e urtë popullore duke u bazuar tek fotoja.



A i gjeni dot emrat e kafshëve të detit tek tabela e mëposhtme?

3			6		4			8
			1	9	2			
4	6			8			7	9
2	7	5					4	3
	3						8	
9	4					6	1	5
8	1		4				5	2
			3	5	9			
6			2		1			4



KAFSHËT E DETIT

MIDHJE

GAFORRE

LOPË DETI

GOCË DETI

DELFIN

OKTAPOD



BALENË



PESHKAQEN



KARAVIDHE



KALË DETI




FOKË



TON



M	K	E	O	P	E	G	E	N	S	G	H	D
C	I	H	R	T	N	O	C	M	I	A	B	O
Q	A	D	A	B	F	C	N	T	U	T	G	P
L	S	I	H	B	O	E	E	R	O	I	A	A
D	R	V	C	J	K	D	Q	S	M	N	F	T
E	N	A	V	B	E	E	A	C	V	Y	O	K
L	M	R	U	L	P	T	K	B	Z	U	R	O
F	B	A	A	N	M	O	H	E	O	I	R	A
I	U	K	Q	S	A	C	S	N	M	P	E	F
N	T	B	N	Q	V	P	E	A	O	R	Y	G
V	A	Q	U	N	L	O	P	E	D	E	T	I
F	Z	O	B	A	L	E	N	E	H	J	K	L





- 1** Gjeni 15 ndryshimet mes dy fotove.
- 2** Një nga peshqit është tre herë në foto. Gjeje dhe secilin vendose brenda një katrori.
- 3** Tek fotoja e parë është një peshk që nuk është tek fotoja tjetër. Gjeje dhe shkruaja emrin,
- 4** Plotësojeni foton e parë me njërën nga copëzat që ndodhet poshtë.

